



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

**VENDIM**  
**Nr. 339, datë 24.09.2020**

**PËR**  
**PËRFSHIRJEN E KANDITATES ZNJ. {...}, NË PROCEDURAT E KOMANDIMIT SI**  
**NDIHMËSMAGJISTRATE PRANË GJYKATËS SË LARTË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në shkronjën “ë”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61, në shkronjën “d” të nenit 86, në shkronjë “b”, pika 1, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 53, 54, 56, 57 dhe 58, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe pikën 4, të nenit 34, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, pasi shqyrtoi kërkesën e kandidatës për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë bazuar në Vendimin nr. 258, datë 23.07.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e opinionit për kandidaten, gjyqtaren {...} e cila ushtron funksionin e saj pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.
2. Publikimin e këtij opinionit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**